

# Ligj për njohjen e kualifikimeve profesionale

## I. Dispozita themelore

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen procedura dhe organet kompetente për lëshimin e lejes për dhënien e shërbimeve nga të huajt në Republikën e Maqedonisë, procedura dhe organet kompetente për njohjen e kualifikimeve profesionale për profesionet e rregulluara të njohura me parimin e automatizmit (në tekstin e mëtejshëm: profesione sektoriale) si dhe procedura dhe organet kompetente për njohjen e kualifikimeve profesionale për profesionet e rregulluara që hyjnë në sistemin e përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara).

### Neni 2

Profesionet sektoriale në Republikën e Maqedonisë janë:

- doktor i mjekësisë,
- doktor specialist i mjekësisë,
- doktor i mjekësisë dentale,
- doktor specialist i mjekësisë dentale,
- infermiere e diplomuar,
- akusher,
- arkitekt,
- doktor i mjekësisë veterinare dhe
- farmacist.

### Neni 3

Sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara i përfshin profesionet e përcaktuara në regjistrin nga neni 48 paragrafi (2) alineja 2 e këtij ligji.

### Neni 4

(1) Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë me shtetasit e vendeve anëtare të Unionit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: UE), Hapësirës Ekonomike Evropiane (në tekstin e mëtejshëm): HEE) dhe Konfederatës Zvicerane të cilët kanë marrë kualifikime profesionale për kryerjen e profesioneve sektoriale, si dhe kualifikime profesionale nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara.

(2) Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë edhe me shtetasit nga shtetet e treta të cilët kanë marrë kualifikime profesionale nga paragrafi (1) i këtij neni në UE, në HEE ose në Konfederatën Zvicerane, e të cilët dëshirojnë të japin shërbime në Republikën e Maqedonisë.

## Neni 5

Shprehje të veçanta të përdora në këtë ligj e kanë kuptimin vijues:

1. "Kualifikime profesionale" janë kualifikimet e fituara me mbarimin e arsimit të mesëm dhe arsimit të lartë profesional, me mbarimin e arsimit të lartë si dhe me aftësimin profesional të kandidatit në pajtim me programet arsimore dhe programet për aftësim, me të cilat kandidati e fiton të drejtën që ta kryejë profesionin e caktuar në vendet anëtare të UE-së, HEE-së ose në Konfederatën Zvicerane.
2. "Profesione sektoriale" janë profesionet për të cilat njohja e kualifikimeve të fituara profesionale në vendin anëtar të UE-së, në HEE ose në Konfederatën Zvicerane, në Republikën e Maqedonisë kryhet nga ministria kompetente ose organi tjetër kompetent në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara nga ministri kompetent pa përcaktimin e kushteve dhe kritereve plotësuese.
3. "Sistem i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara" është sistemi i profesioneve të regjistruara dhe të rregulluara nga ana e ministrisë kompetente, për të cilat organet kompetente e mbajnë të drejtën që të përcaktojnë kualifikime të nevojshme minimale të cilat kandidati duhet t'i posedojë për ta siguruar kualitetin e shërbimit që do ta japë në Republikën e Maqedonisë dhe/ose të përcaktojë kërkesa plotësuese, në dispozitat nga sfera adekuate.
4. "Dëshmi për kualifikime formale" janë diplomat, certifikatat dhe dëshmitë tjera të lëshuara nga organi kompetent, me të cilat vërtetohet marrja e suksesshme e kualifikimeve profesionale.
5. "Ministri kompetente ose organ tjetër kompetent" është ministria, oda ose organi tjetër i autorizuar për kryerjen e punëve të përcaktuara në këtë ligj dhe në dispozitat nga sfera për kualifikimin profesional adekuat.
6. "Periudhë e përshtatjes" është periudha në të cilën kandidati në mënyrë provuese e kryen profesionin nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara nën udhëheqjen e mentorit të akredituar në pajtim me dispozitat e vlefshme në Republikën e Maqedonisë.
7. "Kontroll i aftësisë profesionale të kandidatit" është procesi i kontrollit të dijeve, shkathtësive dhe kompetencës së kandidatit.
8. "Kryerje e kohëpaskohshme e veprimtarisë" do të thotë kryerja e profesionit të personit të caktuar për periudhë të caktuar kohore në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose në Konfederatën Zvicerane dhe
9. "Kompetencë" do të thotë aftësia e dëshmuar e kandidatit për përdorimin e dijes, shkathtësive dhe aftësive tjera në pajtim me standardet e përcaktuara në profesion.

## **II. Lëshimi i lejes të huajit për dhënien e shërbimit nga profesionet sektoriale në Republikën e Maqedonisë**

### Neni 6

Shtetasit e vendeve anëtare të UE-së, HEE-së dhe të Konfederatës Zvicerane, si dhe shtetasit e shteteve të treta të cilët kanë marrë kualifikime profesionale për dhënie shërbimi të profesioneve sektoriale në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose në Konfederatës Zvicerane, mund ta japin shërbimin përkohësisht edhe në Republikën e Maqedonisë nëse kjo nuk është në kundërshtim me ligjet dhe dispozitat e Republikës së Maqedonisë.

### Neni 7

Lëshimi i lejes për dhënien e shërbimit nga profesionet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji të shtetasve nga vendet anëtare të UE-së, HEE-së dhe të Konfederatës Zvicerane, si dhe shtetasve nga shtetet e treta të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, kryhet në pajtim me dispozitën me të cilën rregullohet sfera për kualifikimin profesional adekuat.

## **III. Procedura për lëshimin e lejes për të huajin për dhënien e shërbimit nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara**

### Neni 8

(1) Procedurën për lëshimin e lejeve për të huaj për dhënien e shërbimeve nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara, e udhëheq ministria që është kompetente të veprojë për kërkesën për lëshimin e lejes për dhënien e shërbimeve të huajit në Republikën e Maqedonisë, për profesion të rregulluar konkret (në tekstin e mëtejme: ministria kompetente) ose oda përkatësisht organi tjetër i autorizuar nga ministria kompetente që të kryejë punë të përcaktuara me këtë ligj (në tekstin e mëtejme: organi kompetent).

(2) Në procedurën nga paragrafi (1) i këtij neni ministria kompetente ose organi tjetër kompetent e shqyrton natyrën, kohëzgjatjen, rregullsinë, vazhdimësinë e dhënies së shërbimeve, kualifikimet e nevojshme profesionale të cilat kandidati duhet t'i ketë për dhënien e shërbimit, mënyrën e dhënies së shërbimit nga profesioni i përfshirë në sistemin e përgjithshëm të profesioneve të rregulluara, si dhe sigurimin profesional dhe llojet tjera të sigurimit.

### Neni 9

(1) Kërkesën nga neni 8 paragrafi (1) i këtij ligji, i huaji detyrohet që ta parashtojë edhe në rast kur pas fillimit të dhënies së shërbimit kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në rrethanat e lidhura me shërbimin.

(2) I huaji kërkesën nga neni 8 paragrafi (1) i këtij ligji dhe paragrafi (1) i këtij neni, mund ta parashtojë me shkrim ose në formë elektronike me dokumentacionin e nevojshëm të bashkangjitur.

## Neni 10

(1) Kërkesa nga neni 8 paragrafi (1) i këtij ligji i përmban:

- të dhënat personale të të huajit, dhe atë: emrin dhe mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, gjininë, numrin e dokumentit të udhëtimit dhe titullin e saktë të shërbimit që del nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara që i huaji dëshiron ta japë,
- vërtetimin me shkrim për kualifikime të marra profesionale,
- të dhënat për sigurim në rast të dëmit të bërë dhe llojet tjera të sigurimit që janë të lidhura me dhënien e shërbimeve nga profesioni i përfshirë në sistemin e përgjithshëm të profesioneve të rregulluara si dhe
- kohën për të cilën i huaji do ta japë shërbimin nga profesioni i përfshirë në sistemin e përgjithshëm të profesioneve të rregulluara.

(2) Kërkesën për dhënien e lejes për të huajin për dhënie të shërbimit nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara, i huaji detyrohet ta parashtojë çdo vit, nëse shërbimin e kryen në vazhdimësi.

## Neni 11

Gjatë paraqitjes së parë për dhënien e shërbimit si dhe gjatë parashtrimit të kërkesës nga neni 10 paragrafi (1) I këtij ligji, ministria kompetente ose organi kompetent mund të kërkojë plotësim të kërkesës me shkrim ose elektronike të të huajit me këto të dhëna:

- vërtetim me shkrim të lëshuar nga organi kompetent i cilitdo vend anëtar të UE-së, HEE-së ose të Konfederatës Zvicerane, se shtetasit nga neni 4 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji mund ta japin shërbimin në pajtim me rregullat e vlefshme të vendit ku është dhënë vërtetimi dhe
- vërtetim me shkrim se në momentin e dhënies së vërtetimit nga alineja 1 e këtij neni, i huaji nuk ka të evidentuar ndalim për kryerjen e përkohshme ose të vazhdueshme të profesionit.

## Neni 12

Kur shërbimi në Republikën e Maqedonisë jepet me titullin e profesionit të regjistruar në shtetin ku është i punësuar i huaji ose me titullin e kualifikimit profesional që e posedon i huaji, atëherë ministria kompetente ose organi kompetent mund t'i kërkojë edhe këto informata:

- numrin e regjistrimit me të cilin është regjistruar subjekti ku është punësuar i huaji në regjistrin e subjekteve afariste ose ndonjë regjistër tjetër publik në shtetin ku gjendet selia e subjektit,
- emrin dhe adresën e organit kompetent që e ka lejuar profesionin në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose në Konfederatës Zvicerane,
- dokumentin e lëshuar nga cilado shoqatë profesionale ose subjekt i ngjashëm se në regjistrin e tyre është regjistruar punësimi i të huajit,
- titulli i profesionit ose i kualifikimeve profesionale të përkufizuara në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose në Konfederatës Zvicerane dhe
- të dhëna të detajuara për sigurimin nga dëmi i shkaktuar profesional ose lloje tjera të sigurimit të lidhura me përgjegjësinë profesionale të dhënësit të shërbimit.

### Neni 13

Të dhëna plotësuese dhe kushte të nevojshme për lëshimin e lejes për dhënien e çfarëdo lloj shërbimi nëse ato dalin nga natyra e shërbimit mund të përcaktohen edhe me ligj tjetër.

### Neni 14

(1) Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent detyrohet që në afat prej një muaji nga pranimi i kërkesës dhe dokumenteve të nevojshme:

- ta njoftojë të huajin se kualifikimi i tij profesional është nga profesionet sektoriale që nuk i nënshtrohen kontrollit,
- t'i japë leje për dhënien e shërbimeve nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë, nëse i përmbush kushtet e përcaktuara me ligj ose
- t'i dorëzojë njoftim se cilat kushte plotësuese duhet t'i përmbushë i huaji.

(2) Nëse ministria kompetente ose organi kompetent konstaton dallim më të madh ndërmjet kualifikimit profesional që i huaji e posedon dhe aftësisë profesionale që kërkohet në Republikën e Maqedonisë, duhet t'i mundësoj të huajit, që në afat të caktuar të marrë njohuri dhe aftësi plotësuese dhe aftësi tjera që nuk i posedon.

### Neni 15

(1) Ministria kompetente ose organi kompetent në afat prej një muaji pas pranimi të dëshmimeve për njohuritë dhe aftësitë e fituara plotësuese dhe aftësitë tjera, i lëshon të huajit leje për dhënien e shërbimeve nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara.

(2) Me lejen nga paragrafi (1) të këtij neni, i huaji ka të drejtë të japë shërbime që dalin nga titulli i profesionit të përfshirë në sistemin e përgjithshëm të profesioneve të rregulluara.

### Neni 16

Nëse ministria kompetente ose organi kompetent nuk lëshon leje në afatin e paraparë në nenin 15 paragrafi (1) të këtij ligji dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk e njofton të huajin për kërkesën e parashtruar, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative dhe ligjit me të cilin rregullohen punët nga sfera e kualifikimit përkatës profesional, që i përkasin heshtjes së administratës.

### Neni 17

Nëse profesioni që e kryen i huaji në vendin e vet është profesion i parregulluar, i huaji detyrohet që shërbimin ta japë në shtetin e vet vazhdimisht ose së paku dy vjet nga dhjetë vitet e fundit para se të mund ta japë shërbimin edhe në Republikën e Maqedonisë.

## Neni 18

(1) Shërbimet jepen në pajtim me titullin e profesionit të regjistruar në shtetin ku është punësuar i huaji.

(2) Nëse në shtetin nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ekziston titull i profesionit, i huaji duhet ta shënojë në kërkesë titullin e kualifikimit të fituar profesional në gjuhë zyrtare të shtetit.

(3) Me përjashtim, kur bëhet fjalë për kualifikim profesional nga profesionet sektoriale, shërbimi mund të emërohet sipas titullit të profesionit të regjistruar në Republikën e Maqedonisë.

## Neni 19

Gjatë paraqitjes së parë të dhënies së shërbimit nga i huaji në Republikën e Maqedonisë që mund të shkaktojë dëm serioz në shëndetin dhe sigurinë e shfrytëzuesve të shërbimit që është definuar në rregullat e rajonit konkret profesional, e profesion që nuk është nga radhët e profesioneve sektoriale, ministria kompetente, përkatësisht organi kompetent para se të fillojë me dhënien e shërbimit mund të kërkojë që të kontrollohet kualifikimi profesional i të huajit.

## IV. Procedura për njohjen e kualifikimeve profesionale

### Neni 20

(1) Procedurën për njohjen e kualifikimeve profesionale e udhëheq ministria kompetente ose organi tjetër kompetent në pajtim me kushtet për njohjen e kualifikimeve profesionale në territorin e Republikës së Maqedonisë, të përcaktuara në këtë ligj dhe me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(2) Në procedurën nga paragrafi (1) i këtij neni, ministria kompetente ose organi tjetër kompetent i kryen këto aktivitete:

- pranon kërkesa nga palët e interesuara, zbaton procedurë dhe lëshon aktvendime për njohjen e kualifikimeve profesionale,
- mban regjistra për evidencë të aktvendimeve të lëshuara për njohjen e kualifikimeve profesionale si dhe të dhëna tjera statistikore,
- i njofton palët e interesuara për kushtet në të cilat kryhet profesioni nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara,
- dorëzon raport vjetor në ministrinë kompetente për arsim, për zbatimin e këtij ligji dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

### Neni 21

Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent lëshon vërtetime për vlefshmërinë e diplomave dhe certifikatave për kualifikimet e fituara profesionale të shtetasve të Republikës së Maqedonisë, të lëshuara nga institucionet kompetente në republikat dhe krahinat e ish RSFJ-së si dhe vërtetime për vlefshmërinë e diplomave dhe certifikatave për kualifikime të fituara

profesionale të shtetasve të huaj, të lëshuara nga institucionet kompetente në ish Republikën Socialiste të Maqedonisë.

#### Neni 22

Procedura për njohjen e kualifikimit profesional (në tekstin e mëtejme: procedura) fillon me parashtrimin e kërkesës për njohjen e kualifikimit profesional nga ana e kandidatit në ministrinë kompetente ose organin tjetër kompetent (në tekstin e mëtejme: kërkesë).

#### Neni 23

Forma dhe përmbajtja e kërkesës dhe udhëzimet për plotësimin e saj përcaktohen në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet sfera për kualifikim përkatës profesional.

#### Neni 24

(1) Kërkesës i bashkëngjiten edhe këto dokumente:

- certifikata e shtetësisë e lëshuar nga organi kompetent,
- diploma për arsimin e kryer,
- dokumenti i lëshuar nga organi kompetent për aftësim profesional dhe përvoja profesionale të kandidatit dhe
- dokumenti për posedimin e kualifikimeve tjera.

(2) Dokumentet nga paragrafi (1) i këtij neni, kandidati i dorëzon në përkthim të vërtetuar nga noteri.

(3) Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent gjatë procedurës, e mban të drejtën që t'i kërkojë dokumentet origjinale për shikim.

#### Neni 25

Dokumentacioni i plotë relevant për procedurën mund të dorëzohet në ministrinë kompetente ose organin tjetër kompetent edhe në formë elektronike.

#### Neni 26

Nëse kandidati ka fituar përvojë profesionale në rajonin e profesionit të rregulluar në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose Konfederatës Zvicerane së paku tre vjet, dhe nëse vendi anëtar i UE-së, HEE-së ose Konfederatës Zvicerane pranon se kandidati posedon kualifikim profesional, përvoja e fituar profesionale konsiderohet valide edhe në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 27

Gjatë procedurës merren parasysh edhe dokumentet për posedim të autorizimeve specifike të lëshuara nga shoqata profesionale ose organizata të regjistruara në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose Konfederatës Zvicerane.

## Neni 28

(1) Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent në rast të kërkesës së dorëzuar të parregullt ose jo të plotë, detyrohet që në afat prej pesë ditësh pas pranimit të kërkesës ta njoftojë kandidatin për parregullsinë ose paplotshmërinë e kërkesës, e sipas nevojës mund të kërkojë edhe dëshmi plotësuese.

(2) Gjatë procedurës ministria kompetente ose organi tjetër kompetent mund të kërkojë mendim nga oda kompetente ose organi tjetër profesional ose organizata në lidhje me kërkesën e parashtruar.

(3) Mendimi nga paragrafi (2) i këtij neni, duhet të dorëzohet më së voni në afat prej 14 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës në ministrinë kompetente ose organin tjetër kompetent.

(4) Mendimin nga paragrafi (2) i këtij neni oda kompetente ose organi ose organizata tjetër profesionale e dorëzon pa kompensim.

(5) Mendimi i marrë nga oda ose organi ose organizata tjetër profesionale nuk është i detyrueshëm për ministrinë kompetente ose për organin tjetër kompetent.

(6) Nëse oda kompetente ose organi ose organizata tjetër profesionale nuk jep mendim në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, ministria kompetente ose organi tjetër kompetent mund të lëshojë aktvendim edhe pa atë mendim.

## Neni 29

Në rast se kërkesa e kandidatit është e rregullt dhe e plotë, ministria kompetente ose organi tjetër kompetent detyrohet që të lëshojë aktvendim dhe t'ia dorëzojë kandidatit më së voni në afat prej dy muajsh nga dita e pranimit të kërkesës.

## Neni 30

(1) Gjatë procedurës ministria kompetente ose organi tjetër kompetent e krahason dokumentacionin e arritur me shkrim për kualifikimet profesionale të kandidatit me kualifikimet profesionale të nevojshme për kryerjen e profesionit konkret nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara.

(2) Nëse ministria kompetente ose organi tjetër kompetent gjatë krahasimit konstaton se kandidati nuk i përmbush kushtet për kryerjen e profesionit konkret nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara, mund të lëshojë aktvendim për kryerje të përkohshme të profesionit me detyrim që kandidati në afat prej një muaji të marrë masa plotësuese për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe atë:

- kontroll plotësues të aftësisë profesionale të kandidatit para organit kompetent ose
- t'i përcaktojë kandidatit periudhë kohore për përshtatje dhe përmbushjen e kushteve të cilat mungojnë për profesionin e kërkuar.



(3) Me aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, i huaji mund ta kryejë përkohësisht profesionin vetëm me mentorim të mentorit të akredituar.

(4) Koha për të cilën ministria kompetente ose organi tjetër kompetent e lëshon aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, përcaktohet në aktvendim në pajtim me rregullat nga sfera adekuate.

#### Neni 31

Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent mund të kërkojë nga kandidati kontroll plotësues të aftësisë profesionale në afat prej tre vitesh nëse:

- kohëzgjatja e aftësisë profesionale të kandidatit për të cilën janë parashtruar dokumente është së paku për një vit më e shkurtër nga numri i viteve të nevojshme për aftësim në Republikën e Maqedonisë,
- kualifikimet profesionale që i ka fituar kandidati përmbajnë lëndë teorike dhe/ose praktike, përkatësisht përmbajtje që janë në mënyrë të konsiderueshme të ndryshme nga lëndët përkatësisht përmbajtjet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë në profesionin konkret të rregulluar në Republikën e Maqedonisë, e të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e profesionit nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara dhe
- profesioni nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara përfshin një ose më shumë profesione që nuk janë të përfshira në profesionet e rregulluara në vendin anëtar të UE-së, HEE-së dhe në Konfederatën Zvicerane prej nga vjen kandidati. Dallimi në shtrirjen ndërmjet profesioneve të rregulluara përcakton se cili aftësim profesional i kandidatit kërkohet në Republikën e Maqedonisë dhe cilat lëndë teorike dhe/ose praktike përkatësisht përmbajtje janë të ndryshme në mënyrë të konsiderueshme nga lëndët e përmbajtura në diplomën, certifikatën ose dëshminë tjetër të lëshuar për kualifikimet e fituara profesionale të kandidatit.

#### Neni 32

Kandidati ka për detyrë që të kalojë nëpër procesin e kontrollit të aftësimin të tij profesional për profesione të theksuara në evidencën e profesioneve për të cilat kërkohet njohje e hollësishme e sistemit juridik të Republikës së Maqedonisë, ose kur profesioni është i lidhur me dhënien e konsultimeve dhe këshillave në lidhje me sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 33

(1) Nëse ministria kompetente ose organi tjetër kompetent miraton aktvendim të përkohshëm në të cilin kërkohet nga kandidati që të përmbush ndonjë masë plotësuese, atëherë në aktvendimin e përkohshëm duhet të definohen:

- kohëzgjatja e periudhës provuese që dallohet në çdo rast konkret,
- programi sipas të cilit do të realizohet periudha provuese dhe
- kriteret për vlerësim të suksesit të periudhës provuese si dhe kushtet për kontroll të aftësisë profesionale të kandidatit.

(2) Aktvendimi i përkohshëm nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban edhe listë të lëndëve përkatësisht përmbajtjeve që i mungojnë kandidatit, e që përcaktohet në bazë të krahasimit të

kualifikimeve profesionale që kandidati i posedon dhe kualifikimeve profesionale që kërkohen për profesionin konkret në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 34

Kundër aktvendimit të përkohshëm kandidati mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

#### Neni 35

(1) Pas pranimit të aktvendimit të përkohshëm në afat prej pesë ditësh kandidati detyrohet që ta njoftojë ministrinë kompetente ose organin tjetër kompetent se cilën masë plotësuese nga neni 30 paragrafi (2) alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji pranon ta realizojë.

(2) Në rast se e pranon periudhën provuese për përshtatje, kandidati detyrohet që të dorëzojë vërtetim në ministrinë kompetente ose organin tjetër kompetent ku do ta realizojë periudhën provuese dhe nën mentorim të kujt.

(3) Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e parashtrimit të vërtetimit e informon kandidatin nëse i jep leje për realizimin e periudhës provuese.

#### Neni 36

Në periudhën provuese kandidati e kryen profesionin e vet nën mentorimin e mentorit të akredituar dhe në vendin e punës të cilin vet e ka zgjedhur, e i cili është miratuar me aktvendim nga ministria kompetente ose organi tjetër kompetent.

#### Neni 37

(1) Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent i lëshon aktvendim kandidatit për pranimin e kualifikimeve të tij profesionale për kryerjen e profesionit konkret nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë, nëse:

- kandidati i plotëson kualifikimet profesionale për kryerjen e profesionit nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara të përcaktuara në ligjet dhe dispozitat e Republikës së Maqedonisë dhe
- kandidati dorëzon vërtetim për kryerjen e suksesshme të periudhës provuese ose kontrollit të aftësisë së tij profesionale.

(2) Të drejtë të kryerjes së profesionit konkret nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë, fiton kandidati i cili i plotëson edhe kushtet tjera të definuara në këtë ligj.

#### Neni 38

(1) Me aktvendimin e dhënë për pranimin e kualifikimeve profesionale kandidati e fiton të drejtën që ta kryejë profesionin nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara për të cilin është aftësuar në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose në Konfederatën Zvicerane në kushte të njëjta si edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

(2) Nëse kualifikimi profesional dallohet në atë masë që me periudhën provuese ose me kontroll të aftësisë profesionale të kandidatit nuk është e mundur që të fitohet kualifikimi i nevojshëm profesional në Republikën e Maqedonisë, ministria kompetente ose organi tjetër kompetent miraton aktvendim për mospranimin e kualifikimit profesional.

#### Neni 39

Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent detyrohet që ta informojë kandidatin në të gjitha fazat e procedurës dhe t'i sigurojë kontroll në dokumentacionin e plotë lidhur me kërkesën.

#### Neni 40

(1) Kandidati që ka marrë aktvendim për pranimin e kualifikimit profesional për kryerjen e profesionit konkret sektorial si dhe profesionit nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë, duhet ta zotërojë gjuhën maqedonase.

(2) Niveli i njohjes së gjuhës nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet në pajtim me dispozitën e miratuar nga ministri kompetent ose nga organi tjetër kompetent në pajtim me ligjin.

#### Neni 41

(1) Lartësia e shpenzimeve të nevojshme për realizimin e periudhës provuese nën mentorim të mentorit të akredituar, lartësia e shpenzimeve për arsimimin plotësues dhe aftësimin e kandidatit në periudhën provuese si dhe shpenzimet për kontrollin e aftësisë profesionale të kandidatit, përcaktohen sipas kriterëve të përcaktuara me ligjin me të cilin rregullohet sfera për kualifikimin adekuat profesional.

(2) Shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk guxojnë të jenë më të larta nga shpenzimet të cilat për qëllim të njëjtë janë përcaktuar për shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 42

Procedura para ministrisë kompetente ose organit tjetër kompetent udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative nëse me këtë ligj ose ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 43

Kundër aktvendimit të ministrisë kompetente ose organit tjetër kompetent kandidati mund të ngritë konteste administrative para gjykatës kompetente.

## **V. Kompetencat e ministrisë kompetente për arsim në procedurën e pranimi të kualifikimeve profesionale**

Neni 44

(1) Për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet ministrive kompetente dhe organeve tjera kompetente në procesin e pranimi të kualifikimeve profesionale, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon grup koordinues ndërresorial për kualifikime profesionale.

(2) Anëtarët e grupit ndërresorial koordinues nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Me grupin ndërresorial koordinues nga paragrafi (1) i këtij neni, udhëheq koordinatori nacional.

(4) Koordinator nacional është përfaqësuesi i ministrisë kompetente për arsim.

(5) Koordinator nacional e përfaqëson Republikën e Maqedonisë në grupin koordinues të Komisionit Evropian.

Neni 45

Në procedurën e pranimi të kualifikimeve profesionale ministria kompetente për arsim i ka kompetencat si vijojnë:

- ta koordinojë tërë procesin e pranimi të kualifikimeve profesionale në Republikën e Maqedonisë,
- ta koordinojë implementimin dhe zbatimin unik të këtij ligji si dhe të dispozitave që dalin nga ai,
- ta përcjellë zbatimin e këtij ligji si dhe të dispozitave të miratuara për zbatimin e tij,
- t'i informojë dhe t'u sugjerojë ministrive kompetente dhe organeve kompetente për parregullsitë e konstatuara gjatë zbatimit të dispozitave të këtij ligji,
- të dorëzojë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë raport vjetor për punën e vet, si dhe për rezultatet nga pranimi i kualifikimeve profesionale dhe
- të dorëzojë në Komisionin Evropian raport vjetor për zbatimin e këtij ligji si dhe të dhëna statistikore për aktvendimet e miratuara në lidhje me pranimin e kualifikimeve profesionale.

Neni 46

(1) Ministria kompetente për arsim si koordinatorë në procesin e pranimi të kualifikimeve profesionale i kryen edhe punët vijuese:

- i informon kandidatët dhe pikat kontaktuese në vendet tjera anëtare të UE-së, HEE-së dhe

Konfederatës Zvicerane për të dhënat e nevojshme për pranimin e kualifikimeve profesionale në Republikën e Maqedonisë dhe

- në bashkëpunim me ministrinë dhe organet tjera kompetente si dhe në bashkëpunim me pikat tjera kontaktuese në vendet anëtare të UE-së, HEE-së dhe Konfederatës Zvicerane, u ndihmon kandidatëve që t'i realizojnë të drejtat që dalin nga ky ligj.

(2) Ministria kompetente për arsim detyrohet që në afat prej dy muajsh nga kërkesa e dorëzuar nga ana e Komisionit Evropian t'i dërgojë Komisionit informatë për rezultatet nga përkrahja e realizuar e kandidatëve, e përcaktuar në paragrafin (1) alineja 2 e këtij neni.

## **VI. Evidencat dhe mbajtja e regjistrave**

### Neni 47

(1) Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent i mban evidencat dhe regjistrat vijues:

- evidencën dhe regjistrin e kërkesave të parashtruara për lëshimin e lejeve të huajve për dhënie e shërbimit nga profesionet sektoriale dhe lejet e lëshuara,
- evidencën dhe regjistrin e kërkesave të parashtruara për lëshimin e lejeve të huajve për dhënie e shërbimit nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara dhe lejet e lëshuara,
- evidencën dhe regjistrin për aktvendimet e dhëna në procedurën për pranimin e kualifikimeve profesionale dhe
- evidencën dhe regjistrin e mjeteve juridike të parashtruara kundër miratimit të aktvendimeve nga ministria kompetente ose organi tjetër kompetent.

(2) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave dhe regjistrave nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri kompetent i arsimit.

(3) Evidencat dhe regjistrat nga paragrafi (1) i këtij neni, mbahen me shkrim dhe në formë elektronike.

### Neni 48

(1) Ministria kompetente e arsimit i mban:

- Regjistrin për profesionet sektoriale dhe
- Regjistrin për profesionet nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë.

(2) Ministri kompetent i arsimit i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave dhe regjistrave nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Regjistrat nga paragrafi (1) i këtij neni, mbahen me shkrim dhe në formë elektronike.

### Neni 49

Ministria kompetente e arsimit e mban dhe e azhurnon evidencën e listave në vijim:

- Lista 1 - profesione për të cilat kërkohet diplomë universitare e cila merret me arsimimin dhe

aftësimin e kandidatit në kohëzgjatje së paku prej tre vitesh,

- Lista 2-a - profesione për të cilat kërkohet diplomë universitare e cila merret me arsimimin dhe aftësimin e kandidatit në kohëzgjatje prej më pak se tre vite,
- Lista 2-b - profesione për të cilat kërkohet diplomë e shkollës së mesme,
- Lista 2-v - profesione për të cilat kërkohet vërtetim për aftësinë profesionale të kandidatit,
- Lista 3 - profesione për të cilat kandidati nuk ka mundësi për zgjedhje ndërmjet periudhës provuese të përshtatjes dhe kontrollit të aftësisë profesionale,
- Lista 4 - profesione për kryerjen e të cilave kërkohet njohuri e përgjithshme arsimore, njohuri profesionale, si dhe shkathtësi dhe përvoja profesionale dhe
- Lista 5 - profesione të rregulluara me direktiva sektoriale ose me ligje nacionale për çdo sektor konkret.

Neni 50

Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent dorëzon të dhëna nga evidencat e përcaktuara në nenin 49 të këtij ligji, me kërkesë të ministrit kompetent të arsimit.

Neni 51

(1) Ministria kompetente e arsimit për regjistrimin e profesionit të ri në sistemin e përgjithshëm të profesioneve të rregulluara, duhet t'i ketë parasysh të dhënat në vijim:

- ligjin, përkatësisht aktin nënligjor me të cilin profesioni konkret është i rregulluar dhe
- përshkrimin e saktë të profesionit (emrin e profesionit, kushtet për kryerjen e profesionit si dhe kërkesat tjera për qasje dhe kryerje të profesionit).

(2) Nëse ministria kompetente ose organi tjetër kompetent vendos të kryejë rirregullimin e profesionit për këtë detyrimisht duhet ta informojë ministrinë kompetente të arsimit.

(3) Krahas informatës nga paragrafi (2) i këtij neni, duhet të theksohet edhe ligji me të cilin është kryer rirregullimi i profesionit.

(4) Evidenca nga neni 49 i këtij ligji është publike dhe e kapshme në ueb faqen e ministrisë kompetente të arsimit.

## **VII. Mbrojtja e të dhënave personale të kandidatit**

Neni 52

(1) Të dhënat të cilat kandidati i dorëzon në ministrinë kompetente ose organin tjetër kompetent për ngritjen e procedurës për pranimin e kualifikimeve profesionale mund të përdoren vetëm në këtë procedurë.

(2) Me kërkesë me shkrim të kandidatit ose me lejen e tij me shkrim, të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të përdoren edhe për qëllime tjera në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

## VIII. Informimi

### Neni 53

Ministria kompetente e arsimit në bashkëpunim me ministritë tjera kompetente dhe organet tjera kompetente boton informator periodik për procedurat e ngritura dhe të kryera për pranimin e kualifikimeve profesionale.

### Neni 54

Ministritë kompetente ose organet e tjera kompetente kanë të drejtë që të organizojnë konsultime, seminare ose takime tjera informative për kushtet dhe procedurën për pranimin e kualifikimeve profesionale të të huajve të cilët vijnë në Republikën e Maqedonisë, si dhe për kushtet të cilat i huaji doemos duhet t'i plotësojë që të marrë leje për kryerjen e profesionit sektorial ose për profesion konkret nga sistemi i përgjithshëm i profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë.

## IX. Bashkëpunimi administrativ

### Neni 55

(1) Ministria kompetente për arsim, ministritë kompetente dhe organet tjera kompetente në Republikën e Maqedonisë, bashkëpunojnë me ministritë kompetente dhe organet tjera kompetente të vendeve anëtare të UE-së, HEE-së dhe Konfederatës Zvicerane.

(2) Bashkëpunimi nga paragrafi (1) i këtij neni nënkupton shkëmbim të të dhënave për pranimin e kualifikimeve profesionale për profesionet konkrete të rregulluara, shkëmbim të të dhënave për autenticitetin e dëshmimeve të parashtruara nga kandidatët dhe të dhënave për firmat ku kandidatët janë të punësuar në pajtim me ligjet e vendeve anëtare të UE-së, HEE-së dhe Konfederatës Zvicerane, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

### Neni 56

(1) Shkëmbimi i të dhënave nga neni 55 paragrafi (2) i këtij ligji ka të bëjë me të dhënat personale në vijim:

- emrin dhe mbiemrin e kandidatit,
- datëlindjen dhe vendlindjen,
- shtetin ku është i punësuar kandidati,
- numrin e regjistrimit të firmës,
- numrin e telefonit dhe adresën e-mail të kandidatit,
- adresën e kandidatit (shtetin, rajonin, vendin, numrin postar, rrugën dhe numrin e shtëpisë),
- adresën alternative,
- shtetësinë e kandidatit,
- emrin e profesionit dhe të dhënat në lidhje me profesionin,
- të dhënat për përcaktimin e kualifikimit profesional të kandidatit,
- të dhënat për kryerjen e profesionit të rregulluar,

- të dhënat për aftësinë profesionale të kandidatit,
- të dhënat për anëtarësimin e kandidatit në shoqata profesionale dhe regjistrimin në regjistrat e tyre,
- të dhënat për përvojën e punës të kandidatit,
- të dhënat për sanksionet e shqiptuara dënuese ose kundërvajtëse,
- të dhënat për vendin e punës në firmë,
- të dhënat për llojin e sigurimit, përkatësisht garancive financiare të cilat dalin nga sigurimi,
- të dhënat për komunikime afariste,
- të dhënat për përfaqësuesit ligjorë,
- të dhënat për aktvendimet e dhëna në lidhje me paaftësinë për pagesat financiare ose falimentim dhe
- të dhënat për dokumentet e parashtruara në procedurën e njohjes së kualifikimeve profesionale dhe ngjashëm.

(2) Ministritë kompetente ose organet tjera kompetente mund të grumbullojnë të dhëna të nevojshme dhe të kryejnë shkëmbim të informatave nga bazat nacionale të të dhënave dhe regjistrat e të dhënave personale.

(3) Gjatë shkëmbimit të të dhënave ministritë kompetente ose organet tjera kompetente, doemos duhet t'i respektojnë ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale

#### Neni 57

Me propozimin e ministrisë kompetente ose organit tjetër kompetent në vendin anëtar të UE-së, HEE-së ose në Konfederatën Zvicerane, Ministria kompetente ose organi tjetër kompetent në Republikën e Maqedonisë kryen kontroll të të dhënave të marra dhe konkluzionet e veta i dorëzon në ministrinë kompetente ose organin tjetër kompetent të vendit anëtar të UE-së, HEE-së ose Konfederatën Zvicerane.

## **X. Dispozita kalimtare dhe të fundit**

#### Neni 58

(1) Ministria kompetente e arsimit siguron kushte kadrovike dhe organizative për realizimin e procedurave të përcaktuara me këtë ligj, më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

(2) Ministria kompetente e arsimit vendos evidencë të profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë, më së voni deri më 31 dhjetor 2012.

(3) Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen më së voni deri më 31 dhjetor 2012.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do ta formojë grupin koordinues ndërresorial.



Neni 59

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen pas aderimit të Republikës së Maqedonisë në UE.

Neni 60

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".





